R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
B A N K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr. 70, datë 30.09.2009

Për miratimin e rregullores
"Për Veprimtarinë Valutore".

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "c" të nenit 43 dhe shkronjave "d" dhe "dh" të pikës 3 të nenit 60 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V e n d o s i:

1. Të miratojë rregulloren "Për Veprimtarinë Valutore", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit në Bankën e Shqipërisë për botimin e kësaj rregulloreje në Fletoren Zyrtare dhe publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të rregullores të miratuar me këtë vendim, rregullorja "Mbi veprimtarinë valutore", miratuar me vendimin nr. 64, datë 07.03.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

5. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli Memisha

KRYETARI
Ardian Fullani

BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE

"Për Veprimtarinë Valutore"

(Miratuar me vendimin nr.70, datë 30.09.2009, ndryshuar me vendim nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Kreu I
Të përgjithshme

Neni 1
Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për kryerjen e veprimeve që regjistrohen në llogarinë korente dhe kapitale, në formën e pagesave dhe transfertave nga dhe në Republikën e Shqipërisë.

2. Veprimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni përfshijnë:

a) veprimet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve nëpërmjet përdorimit të mjeteve të pagesës në valutë;dhe
b) transferimin e njëanshëm të aktiveve nga dhe në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjithë personat juridikë që licencohen nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarive bankare dhe/ose financiare.

Neni 3
Baza Ligjore

1. Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 60, paragrafi 3, shkronja "d" dhe "dh" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;

b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 ‘Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”;

c) kreut IV, nenet 60, 61 dhe 62 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të Shteteve të tyre anëtare; ratifikuar me ligjin 9590, datë 27.07.2006 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të Shteteve të tyre anëtare”;

d) pikës 3, të nenit 1 të ligjit nr. 8648, datë 28.07.2000 “Për ratifikimin e Protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Marrakeshit” që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë”.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose përdorur në:

a) nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 23.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar[1];
b) ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar[2];
c) ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”;
d) ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, i ndryshuar[3];
e) Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar[4].

2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

3. “Rezidentë” janë:

a) shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë me zyrë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar degët e tyre me seli jashtë territorit të Shqipërisë;

[1] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[2] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[3] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[4] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

b) degët e shoqërive të huaja të regjistruara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij;
c) dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
d) personat fizikë tregtarë, që në mënyrë të pavarur ushtrojnë një aktivitet tregtar si punësim parësor dhe që kanë qendrën e ushtrimit të aktivitetit dhe/ose vendbanimin e tyre në Republikën e Shqipërisë;
e) personat fizikë, të cilët kanë vendbanimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
f) personat fizikë/shtetasit e huaj, të cilët kanë vendqëndrimin në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 14 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, dhe të cilët disponojnë në mënyrë të vazhdueshme lejen e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të Huajt";
g) diplomati ose punonjësi shqiptar së bashku me familjarët e tij, të caktuar me punë nga shteti shqiptar në ambasadë, konsullatë apo në organizma ndërkombëtarë jashtë shtetit, të cilët nuk kryejnë ndonjë aktivitet ekonomik apo tregtar;
h) personi fizik që ka vendqëndrimin jashtë Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 14 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili pavarësisht nga kohëzgjatja e qëndrimit jashtë Republikës së Shqipërisë është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të Republikës së Shqipërisë.

4. Të gjithë personat e tjerë të cilët nuk përfshihen në përcaktimet e paragrafit 3 të këtij neni do të konsiderohen si "jorezidentë".

5. "Mjet Pagese në Valutë" - është çdo mjet pagese në formën e kartëmonedhës apo monedhës metalike, të çekut, të kambialit, të premtim-pagesës, të letër-kreditit dhe të urdhrave ose të instrumenteve të tjerë të pagesës të emërtuar në monedha të huaja dhe që janë të pagueshme në monedha të huaja.

6. "Detyrim monetar" - është çdo detyrim për të paguar një shumë të caktuar parash, që paguhet (shlyhet) në vleftën e vet nominale, përveç se kur rezulton ndryshe nga ligji ose nga kontrata.

7. "Këmbim valutor" - është veprimtaria financiare e këmbimit të monedhës kombëtare në valutë dhe/ose anasjelltas, si dhe veprimtaria financiare e këmbimit të dy valutave me njëra tjetrën.

8. "Kurs këmbimi" - është çmimi relativ i një monedhe, i shprehur në njësinë e një monedhe tjetër, që përcaktohet lirisht në tregun e këmbimit valutor, referuar një date të caktuar.

9. "Valutë" janë mjetet financiare në formën e:

a) kartëmonedhave dhe monedhave të huaja të cilat kanë kurs ligjor ose në formën e parasë elektronike (e-money); dhe
b) fondeve dhe depozitave në monedhë të huaj pranë subjekteve bankare të huaja dhe të vendit, të cilat mund të transferohen me anë të mjeteve të pagesës për pagesat në valutë.

10. "Veprime të këmbimit valutor" janë:

a) këmbimi valutor në "*cash"* ose nëpërmjet llogarisë personale ose të të tretëve;
b) shlyerja e kredive dhe huave financiare në monedhë të ndryshme nga ajo me të cilën është akorduar ose pranuar, vetëm nëse kjo nuk është parashikuar në marrëveshjen fillestare me shkrim të palëve;
c) veprimtaria e shitblerjes së valutës në para fizike dhe çeqeve të udhëtarëve ushtruar nga subjektet e liçencuara nga Banka e Shqipërisë.

11. "Para fizike (*cash*)" - janë kartëmonedhat ose monedhat kombëtare dhe/ose të huaja në qarkullim;

12. "Njohja e titujve" - është fillimi i proçedurave për tregtimin e titujve të huaj në Republikën e Shqipërisë ose të titujve të brendshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

13. "Tituj të tregtueshëm në bursë" - janë titujt, tregtimi dhe çmimi i të cilëve është rregullisht i kontrolluar dhe i publikuar nga organet e bursës dhe/ose nga organet e lidhura me të.

14. "Tituj të tregtueshëm në tregun e kapitaleve" - janë aksionet, obligacionet dhe tituj të tjerë të tregtueshëm në tregjet e organizuara ose jo të organizuara të titujve.

15. "Titujt e tregtueshëm në tregun e parasë" - janë titujt me afat maturimi të shkurtër (me pak se një vit) të tillë si bonot e thesarit, dëftesat tregtare, certifikatat e depozitave, premtim-pagesat dhe instrumentet e tjerë të ngjashëm.

16. "Tregu i parasë" - është tregu financiar i huadhënies dhe huamarrjes afatshkurtër, që mundëson fonde likuide afatshkurtra në sistemin financiar. Në tregun e parasë, shiten dhe blihen lirisht, obligacionet afatshkurtra si bonot e thesarit, dëftesat tregtare certifikatat e depozitave të negociueshme, kambialet afatshkurtër etj.

17. "Tregu i kapitaleve" - është tregu ku personat fizikë dhe/ose juridikë tregtojnë titujt e tyre me qëllim sigurimin e shtimit të fondeve të tyre. Ky

treg përbëhet nga : a) tregu primar; dhe b) tregu sekondar, si më poshtë:

a. "tregu primar" – është tregu në të cilin realizohet emetimi i titujve për herë të parë nga shoqëritë tregtare, qeveritë dhe institucionet e tjera publike dhe jopublike;

b. "tregu sekondar" – është tregu në të cilin kryhet rregullisht tregtimi i titujve të emetuar në tregun primar.

18. "Sipërmarrjet kolektive të investimit" - janë shoqëritë dhe/ose fondet e investimit të cilat:

a) kanë si objekt investimin kolektiv të fondeve me origjinë nga publiku dhe që veprojnë mbi bazën e parimit të shpërndarjes së rrezikut; si dhe
b) njësitë e të cilave, me përjashtim të aseteve të këtyre shoqërive/fondeve, riblihen dhe shlyhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë sipas kërkesës së vetë zotëruesit/ve.

19. "Njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit" - janë titujt e emetuar nga shoqëritë/fondet kolektive të investimit, që përfaqësojnë të drejtat e pjesëmarrësve në aktivet e këtyre shoqërive.

20. "Tituj të brendshëm" - janë titujt dhe instrumentet e tjerë të borxhit të emetuar nga rezidentët.

21. "Tituj të huaj" - janë të gjithë titujt dhe instrumentet e tjerë të borxhit të emetuar nga jorezidentët.

22. "Transaksionet me Titujt" - përfaqësojnë transferimin me apo pa shpërblim të pronësisë dhe/ose të të drejtave të tjera mbi titujt, ndërmjet një rezidenti dhe jorezidenti, për titujt e tregtueshëm në tregun e parasë dhe/ose të kapitaleve.

23. "Transaksion" - është marrëdhënia e biznesit që përfshin dy ose më shumë palë me qëllim shkëmbimin e një aseti kundrejt pagesës.

24. "Transaksionet e kapitalit" - janë veprimet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, me qëllim transferimin e kapitaleve, të cilat regjistrohen në llogarinë kapitale të bilancit të pagesave.

25. "Transaksionet korente" - janë veprimet të cilat nuk kanë si qëllim transferimin e kapitaleve dhe regjistrohen në llogarinë korente të bilancit të pagesave.

26. "Transferta të njëanshme të aktiveve nga dhe në Republikën e Shqipërisë" - janë transfertat të cilat nuk rrjedhin nga transaksione korente apo kapitale ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, por marrin formën e transfertave personale dhe fizike të aktiveve.

27. "Transferim" - është kalimi i një titulli pronësie, fondesh ose kapitali pas kryerjes së një transaksioni ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, veprim, i cili regjistrohet në llogarinë kapitale dhe/ose në llogarinë korente të bilancit të pagesave.

28. "Investimet direkte" përfaqësojnë të gjitha llojet e investimeve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentë dhe jorezidentë me qëllim krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme ekonomike.

29. "Ar dhe metale të çmuara" janë:

a) ari dhe metalet e çmuara të standardizuara.
b) ari dhe metalet e çmuara të pa-standardizuara.
c) platini.

30. "Standardizim i arit dhe i metaleve të çmuara" - është forma unike e arit dhe/ose e metaleve të çmuara, e pranuar për t'u këmbyer në tregun ndërkombëtar të arit.

KREU II
VEPRIMET VALUTORE

Neni 5
Llojet e veprimeve valutore

1. Veprimet valutore përfaqësojnë transaksione dhe/ose transferta ndërmjet rezidentëve dhe jorezidenteve dhe anasjelltas, të cilat regjistrohen në llogari të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë dhe përbëhen kryesisht nga:

a) transaksionet dhe transfertat kapitale.
b) transaksionet dhe transfertat korente.

2. Transfertat dhe transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve kryhen lirisht sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 6
Transaksione të kapitalit

1. Transaksionet e kapitalit të përshkruara në paragrafin 24, të nenit 4 të kësaj rregulloreje përfshijnë kryesisht:

a) investimet direkte;
b) investimet në pasuri të paluajtshme;
c) transaksionet me titujt në tregun e kapitaleve;
d) transaksionet me titujt në tregun e parasë;
e) veprime me njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit;
f) transaksionet që lidhen me ekzekutimin e kolateralit dhe/ose të garancive (hipoteka, pengu etj.);
g) transaksionet e kreditit;
h) transaksionet e depozitave;
i) transfertat që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe/ose të ri-sigurimit, kur kjo lejohet nga legjislacioni shqiptar dhe në përputhje me ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", i ndryshuar.

2. Investimet direkte klasifikohen në:

a) investime direkte në Republikën e Shqipërisë nga jorezidentët;
b) investime direkte jashtë Republikës së Shqipërisë nga rezidentët.

3. Në transaksionet e investimeve direkte, të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, përfshihen kryesisht:

a) krijimi ose hapja e degës ose zyrës së përfaqësimit të një shoqërie që zotërohet plotësisht nga personi që jep kapitalin/investuesi,

b) krijimi i një filiali ose blerja e një shoqërie ekzistuese, e cila kalon në kontroll të plotë të investuesit,

c) riorganizimi juridik i shoqërive (me bashkim ose me ndarje),

d) pjesëmarrja në kapitalin aksioner të një shoqërie të re ose ekzistuese, nëse investuesi zotëron ose ka në pronësi mbi 10 për qind të pjesëmarrjes në kapitalin aksioner të shoqërisë ose mbi 10 për qind të të drejtave të votës;

e) kreditë me afat maturimi më shumë se 5 vjet, që lidhen me transaksionet e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "d" të kësaj pike;
f) përdorimi i fitimit nga një investim ekzistues në të njëjtin investim dhe me të njëjtin qëllim (riinvestimi i fitimit).

4. Investimet në pasuri të paluajtshme përfaqësojnë investimet e kryera nga rezidentët dhe jorezidentët me qëllim blerjen e këtyre pasurive si dhe ndërtimin për fitimin e pronësisë ose përdorim personal sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Në këto transaksione përfshihet dhe e drejta e *uzufruktit* ose të drejtat përdorimit.

5. Në transaksionet e investimeve në pasuritë e paluajtshme, të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, përfshihen kryesisht:

a) transfertat dhe transaksionet e kryera nga jorezidentët me objekt investimet në pasuritë e paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë;
b) transfertat dhe transaksionet e kryera nga rezidentët me objekt investimet në pasuritë e paluajtshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Në transaksionet me titujt dhe instrumentet financiare derivativë në tregun e kapitaleve, përfshihen:

a) transaksionet për blerjen nga jo-rezidentët të titujve dhe/ose instrumenteve financiare derivativë të brendshëm të tregtueshëm në bursë ose jo; dhe
b) transaksionet për blerjen nga rezidentët të titujve dhe/ose instrumenteve financiare derivativë të huaj të tregtueshëm në bursë ose jo.

7. Për qëllime të kësaj rregulloreje emetimi i titujve në tregun e kapitaleve përfshin:

a) njohjen e titujve në bursë;
b) emetimin dhe/ose listimin në tregun e kapitaleve, që përfshin:

   i. pranimin e titujve të brendshëm në tregun e huaj të kapitaleve. dhe
   ii. pranimin e titujve të huaj në tregun e brendshëm të kapitaleve.

8. Transaksionet me titujt dhe instrumentet e tjerë të tregut të parasë, përfshijnë:

a) transaksionet për blerjen nga jorezidentët të titujve të brendshëm në tregun e parasë;dhe
b) transaksionet për blerjen nga rezidentët të titujve të huaj në tregun e parasë.

9. Për qëllime të kësaj rregulloreje, emetimi i titujve në tregun e parasë përfshin:

a) njohjen e titujve në tregjet e parasë;

b) emetimin dhe/ose listimin e titujve në tregjet e parasë, që përfshin:

i. pranimin e titujve të brendshëm në tregun e huaj të parasë, dhe
ii. pranimin e titujve të huaj në tregun e brendshëm të parasë.

10. Veprime me njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit përfshijnë:

a) investimet e njësive në titujt e tregut të kapitaleve (aksione obligacione etj.);
b) investimet e njësive në titujt ose instrumentet e tjerë të tregut të parasë;
c) investimet e njësive në asete të tjera.

11. Transaksionet me njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit, përfshijnë:
a) transaksionet për blerjen nga jorezidentët të titujve të shoqërive rezidente, të tregtueshme ose jo në bursë;dhe
b) transaksionet për blerjen nga rezidentët të titujve të shoqërive të huaja jorezidente, të tregtueshme ose jo në bursë.

12. Administrimi i njësive të sipërmarrjeve kolektive të investimit në tregun e kapitaleve përfshin:

a) njohjen e titujve në tregun e kapitaleve;
b) emetimin dhe/ose listimin e titujve në tregun e kapitaleve, që përfshin:

i. pranimin e njësive të sipërmarrjeve kolektive rezidente të investimit, në tregun e huaj të kapitaleve, dhe
ii. pranimin e njësive të sipërmarrjeve kolektive jorezidente të investimit, në tregun e brendshëm të kapitaleve.

13. Transaksionet e kreditit përfshijnë transaksionet që kryhen mbi bazën e një kontrate kredie ndërmjet një rezidenti dhe jorezidenti si dhe anasjelltas. Transaksionet e kreditit përfshijnë:

a) kreditë tregtare, që lidhen me tregtinë ndërkombëtare të mallrave dhe/ose shërbimeve ku një nga palët është rezident, si dhe kreditë tregtare për pagesat e shtyra dhe/ose të avancuara;
b) transaksionet që lidhen me transferimin e të drejtave (*faktoringu)* të cilat kanë lindur nga një transaksion i karakterizuar si kredi tregtare;
c) kreditë të cilat nuk klasifikohen si kredi tregtare, me përjashtim të atyre të përcaktuara në pikën 3, shkronja "e" të këtij neni dhe pikës 2 të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

14. Transaksionet e depozitave përfaqësojnë transaksionet e kryera në bazë të një kontrate, që përfshin hapjen e një llogarie rrjedhëse ose të

një llogarie depozite nga një bankë rezidente në një bankë jorezidente, ose anasjelltas. Në transaksionet e depozitave përfshihen:

a) transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe bankave jorezidente si dhe ndërmjet jorezidentëve dhe bankave rezidente,
b) transaksionet ndërmjet bankave rezidente dhe bankave jorezidente dhe anasjelltas, si dhe
c) transaksionet ndërmjet bankave rezidente dhe institucioneve të tjera financiare të huaja dhe anasjelltas.

15. Transaksionet që lidhen me ekzekutimin e kolateralit dhe/ose të garancive përfshijnë transaksionet e kryera në bazë të një kontrate midis rezidentëve dhe jorezidentëve dhe anasjelltas, të cilat janë në funksion të transaksioneve të përcaktuara në pikat 16 dhe 17 të këtij neni. Këto transaksione dallojnë në transaksione për ekzekutimin e kolateralit dhe/ose garancive:
a) të vendosura nga jorezidentët për rezidentët; dhe
b) të vendosura nga rezidentët për jorezidentët.

16. Transfertat në bazë të kontratës së sigurimit dhe të risigurimit, përfaqësojnë transaksione dhe transferta të premiumeve dhe pagesave të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i kontratave të sigurimit dhe risigurimit midis rezidentëve dhe jorezidentëve dhe anasjelltas.

17. Transfertat e kontratave të sigurimit dhe risigurimit të përcaktuara ne pikën 16 të këtij neni, klasifikohen në:

a) transfertat e primeve dhe pagesave në lidhje me sigurimin e jetës, si më poshtë:

i. kontratat e lidhura midis shoqërive vendase të sigurimit (siguruesi) dhe jo-rezidentëve (përfituesi); dhe
ii. kontratat e lidhura midis shoqërive të huaja të sigurimit (siguruesi) dhe rezidentëve (përfituesi).

b) transferta të primeve dhe pagesave në lidhje me sigurimin e kredisë, si më poshtë:

i. kontratat e lidhura midis shoqërive vendase të sigurimit të kredive (siguruesi) dhe një jorezidenti (përfituesi), dhe
ii. kontratat e lidhura midis shoqërive të huaja të sigurimit të kredive (siguruesi) dhe një rezidenti (përfituesi).

c) transferta të kapitalit mbi kontrata të tjera të sigurimit dhe marrëveshjeve të risigurimit.

18. Në kuptim të këtij neni, veprime në llogarinë kapitale do të konsiderohen edhe transaksionet e tjetërsimit të një investimi të kryera mbi baza ligjore.

Neni 7
Transaksionet korente

1. Transaksionet korente të përcaktuara në pikën 25, të nenit 4 të kësaj rregulloreje, përfshijnë kryesisht:

a) të gjitha pagesat që rrjedhin nga tregtia ndërkombëtare e mallrave, shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera, përfshirë shërbimet dhe instrumentet bankarë afatshkurtër;
b) pagesat e arkëtueshme për interesat e kredisë dhe për të ardhurat neto të investimeve të tjera;
c) pagesat për shpërndarjen e fitimit bazuar në pjesëmarrjen në kapitalin themeltar si dhe pagesat që lidhen me një marrëdhënie kredie me investitorin direkt;
d) transfertat e lidhura me dërgesat e emigrantëve dhe punonjësve jashtë Republikës së Shqipërisë, dërgesat e tjera për shpenzimet jetësore familjare, pensionet, ndihmat financiare për paaftësi pune dhe të tjera përfitime sociale, taksat dhe kuotat e anëtarësimit, transfertat që rrjedhin nga bashkëpunimi ndërqeveritar.

2. Transaksionet të cilat kryhen ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve dhe që regjistrohen në llogarinë korente të bilancit të pagesave mund të kryhen në monedha lirisht të konvertueshme.

3. Transaksionet dhe transfertat korente ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve kryhen lirisht në përputhje me dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 8
Transfertat e njëanshme

1. Transfertat e njëanshme, të përkufizuara në pikën 26 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, përfshijnë transfertat personale të aktiveve dhe transfertat fizike të tyre.

2. Transfertat personale të aktiveve, përfshijnë transfertat me objekt transferimin e aktiveve nga dhe në Republikën e Shqipërisë, që rrjedhin nga huatë, dhuratat, trashëgimitë, shlyerja e detyrimeve nga emigrantët në vendbanimin e tyre të mëparshëm, transfertat e aktiveve të rezidentëve emigrantë për periudhën e qëndrimit të tyre jashtë vendit, të ardhurat nga lojërat e fatit dhe kursimet e personave jorezidentë të punësuar në Republikën e Shqipërisë.

3. Transfertat fizike të aktiveve, përfshijnë transportimin në *"cash"* të monedhës vendase ose të huaj, transferimin e arit dhe metaleve të çmuara si dhe titujt e transferueshëm.

4. Subjektet e licencuara kryejnë transferta të njëanshme të kapitalit për llogari të rezidentëve dhe të jorezidentëve, pas plotësimit të dokumentacionit që vërteton qëllimin e veprimit, të përcaktuar nga vetë subjekti.

KREU III
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Neni 9
Dokumentacioni për transferimin e kapitalit

1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet lirisht dhe pa kufizime.

2. Transferimi i kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të vetë subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, kryhet me vendim të organeve të tyre përkatëse dhe në përputhje me kërkesat rregullative/mbikëqyrëse të vendosura nga Banka e Shqipërisë.

3. Subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të klientëve të tyre pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si më poshtë, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që subjektet mund të çmojnë të arsyeshëm:

a) për personat fizikë tregtarë dhe juridikë:
   i. deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit dhe i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet,
   ii. vendimi i organit vendimmarrës të klientit për kryerjen e transferimit të kapitalit,
   iii. ekstrakti i regjistrit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit,
   iv. [5]

b) për personat fizikë:

[5] Shfuqizuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

i. deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit, deklarimi i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet.

4. Në rastet e parashikuara më poshtë, subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për llogari të klientëve të tyre, vetëm pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si vijon:

a) kur kapitali i hyrë në Shqipëri, i transferuar nëpërmjet një banke jorezidente për qëllime investimi, nuk është përdorur, transferimi kryhet me paraqitjen në bankë të vendimit të organit vendimmarrës të subjektit që konfirmon ndërprerjen e investimit dhe mospërdorimin e shumës së kapitalit të derdhur për këtë qëllim;
b) për transferimin e kapitalit brenda shumës së kapitalit të regjistruar në Shqipëri dhe të ardhurave të siguruara nga investimi i kësaj shume, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni kërkohet dhe dokumentacion shtesë, si më poshtë:
   i. [6]
   ii. vendimi i organit vendimmarrës të subjektit, ku përcaktohet ndarja dhe përdorimi i fitimit.

c) për transaksionet e depozitave që përfshijnë veprimet në një llogari rrjedhëse ose në një llogari depozite nga territori i Republikës së Shqipërisë, kërkohen dokumente justifikues përkatës;
d) për kreditë tregtare me afat maturimi deri në një vit, që lidhen direkt me tregtinë ndërkombëtare dhe me ofrimin e shërbimeve, kërkohet si dokument kontrata e kredisë së lidhur midis rezidentit dhe jorezidentit;
e) për transferimin e valutës, që buron nga depozitat e një jorezidenti dhe/ose të ardhurat që rrjedhin prej tyre, si dokumentacion për transferimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë shërben dokumenti i bankës, që vërteton shumën që transferohet nga depozita/t e tij;
f) për transferimin e valutës nga një emigrant në momentin e largimit nga Republika e Shqipërisë, nëpërmjet një banke apo institucioni financiar jobankë të licencuar nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e shërbimeve të transferimit të parave, kërkohet dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të huaj që vërteton të drejtën e qëndrimit të tij në atë shtet;
g) për transferimin e të ardhurave të siguruara nga pasuria apo nga investimet e një emigranti shqiptar që jeton jashtë Shqipërisë, kërkohet dokumenti i parashikuar në shkronjën "f", pika 4 të këtij neni, si dhe një deklaratë personale mbi burimin e të ardhurave që kërkon të transferojë;

[6] Shfuqizuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

h) [7]për transferimin e kapitalit brenda shumës së kapitalit dhe të ardhurave që rezultojnë nga shitjet, nga likuidimi i pjesshëm ose i plotë i një investimi, kërkohet si dokumentacion shtesë edhe akti i shitjes ose akti i likuidimit nga organi kompetent.

5. Përveç sa parashikohet në këtë rregullore, për transaksionet e pagesave me jashtë në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen njëkohësisht dhe rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, të marrëveshjeve ndërbankare dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe ku Banka e Shqipërisë është palë, si dhe zakoni bankar.

Neni 10
Investimet në tituj

Transaksionet me titujt dhe instrumentet e tjerë të ngjashëm, si dhe ushtrimi i të drejtave që rrjedhin prej tyre, kryhen vetëm nëpërmjet subjekteve bankare dhe/ose subjektet e tjera të autorizuara nga legjislacioni përkatës, sipas një kontrate të përfunduar në lidhje me shërbimet përkatëse të ofruara.

KREU IV
LËVIZJET FIZIKE TË VALUTËS, TË ARIT DHE TË METALEVE TË ÇMUARA

Neni 11
Lëvizjet fizike të valutës në pikat doganore

1. Rezidentët dhe jorezidentët për shumat mbi 1 milion lekë ose kundërvleftën e tyre në valutë janë të detyruar të deklarojnë përpara autoriteteve doganore burimin dhe qëllimin e mbajtjes së tyre.

2. Jorezidentët që vizitojnë përkohësisht Republikën e Shqipërisë, mund të nxjerrin jashtë saj valutë në *"cash"* dhe/ose në çeqe udhëtarësh deri në shumën e deklaruar përpara autoriteteve doganore kur kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shumë justifikohet me paraqitjen e:

a) deklaratës të plotësuar në momentin e hyrjes; dhe
b) dokumentet që shoqërojnë ndryshimet nëse ka të tilla.

[7] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 12
Lëvizjet fizike të arit dhe të metaleve të çmuara në pikat doganore

1. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të standardizuara vetëm nëpërmjet subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në aneksin e licencës së dhënë nga kjo e fundit. Dokumentacioni, që duhet të plotësohet nga subjekti i cili ofron dhe kryen shërbimin e lëvizjes fizike të arit dhe metaleve të çmuara, përcaktohet në pikën 2 të këtij neni.

2. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të pastandardizuara nga pikat doganore, vetëm pas deklarimit në lidhje me:

i. burimin (origjinën) e tij,
ii. qëllimin e transferimit,
iii. sasinë që kërkohet të transferohet,
iv. kthimin ose jo të metaleve të çmuara, dhe
v. formën e kthimit.

3. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni nuk paraqitet për bizhuteritë e përdorimit personal.

KREU V
RAPORTIMET DHE DOKUMENTACIONI

Neni 13
Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Subjektet e kësaj rregulloreje, në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, raportojnë/dërgojnë të dhënat statistikore në përputhje me procedurat dhe sistemin raportues të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 14
Detyrimet e subjekteve për dokumentacionin

1.[8] Dokumentacioni i kërkuar në këtë rregullore dhe në shtojcën nr. 1, të saj paraqitet tek subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë në origjinal, ose në fotokopje të noterizuara nga origjinali. Verifikimi i dokumentacionit kryhet nga subjekti i licencuar i cili bën fotokopjen e dokumentit të

[8] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

paraqitur dhe vendos një vulë të posaçme (datare) mbi secilën nga fletët e fotokopjuara, e cila i jep vlefshmërinë e duhur kopjes së dokumentit të mbajtur nga subjekti.

2. Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë janë të detyruara të plotësojnë dhe të ruajnë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare të gjithë dokumentacionin e parashikuar në këtë rregullore dhe në shtojcën nr. 1 të saj. Në rastet kur kërkohet nga autoritet përgjegjëse për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, periudha e ruajtjes së këtij dokumentacioni mund të jetë më e gjatë.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Dispozitë e fundit

Shtojca n. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje është pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
ARDIAN FULLANI

SHTOJCA NR. 1

MBI
TRANSFERTAT PËR VEPRIMET TREGTARE DHE PËR VEPRIMET JOTREGTARE NË VALUTË

I)[9] Transfertat për veprimet tregtare me mallrat.

1. Për transfertat tregtare me mallra, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre, paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

   a) kërkesa për kryerjen e veprimit e nënshkruar nga vetë kërkuesi ku pasqyrohet natyra e veprimit dhe qëllimi për të cilin kryhet ky veprim. Në këtë kërkesë, subjekti deklaron se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera për të njëjtin mall dhe vlerë;
   b) fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës.

II) Transfertat për veprimet tregtare në rastin e shërbimeve.

Për transfertat tregtare që lidhen me pagesën e shërbimeve, sipas specifikimeve të bëra në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

a)[10] kërkesën sipas paragrafit 1, shkronja "a" (pjesa I) të kësaj shtojce;
b) faturën përkatëse të subjektit ose dokumentin, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës; dhe/ose kontratën apo marrëveshjen përkatëse.

III) Transfertat për veprimet jotregtare.

Për transfertat jo-tregtare, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre, paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) [11] kërkesën sipas paragrafit 1, shkronja "a" (pjesa I) të kësaj shtojce;
b) deklarimin e burimit të të ardhurave në lidhje me kryerjen e transfertës.

[9] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[10] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[11] Ndryshuar me vendimin nr.07, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.